



Raiffeisen
Invest



Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen

- › Qëndrueshmëri financiare dhe transparencë
- › Lehtësi fiskale
- › Kontribut mujor minimal

www.raiffeisen-invest.al

Prospekti i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen është pjesë përbërëse e Kontratës dhe Deklaratës së Pranimit të Pjesëmarrjes në Fond dhe përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi për anëtarësimin në Fond. Kur bën kërkesën për anëtarësim, anëtar i potencial pajtohet me Prospektin dhe kushtet e kontratës së anëtarësimit.

Ky Prospekt nuk përfaqëson ftesë për anëtarësim në fond, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe rreziqet që mbart anëtarësimi në një fond pensioni privat.

Prospekti përmban të dhëna dhe informacione të vlefshme në datën e publikimit të tij, dhe për ndryshime jo thelbësore, ai përditësohet një herë në vit.

Duke qenë se performanca e Fondit në të kaluarën nuk shërben si garanci për të ardhmen, shoqëria administruese fton anëtarët e mundshëm të interesuar të informohen përpara se të marrin një vendim për anëtarësim, në lidhje me kushtet, karakteristikat dhe rreziqet në dokumentet e Fondit (Prospekti, kontrata e anëtarësimit).

Nëse informacioni në dokumentet e Fondit nuk është i mjaftueshëm, të gjitha pyetjet dhe sqarimet duhet t'i drejtohen shoqërisë administruese ose agjentëve të shitjes.

Prospekti i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen është miratuar me Vendim Bordin nr. 66, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në datë 29.04.2025 dhe është publikuar në datë 09.05.2025.

Sistemi i pensioneve në Republikën e Shqipërisë (RSH) mbështetet në dy kolona.

Kolona e parë përbëhet nga sigurimi i detyrueshëm, bazuar në parimin e solidaritetit mes brezave (PAYG), e cila administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në përputhje me Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Çdo person i punësuar së bashku me punëdhënësin janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore (përfshirë kontributet për pension) në Fondin e ISSH në buxhetin e shtetit.

Skema mbështetet në parimin e përfitimit të përcaktuar (DB) i cili financohet pjesërisht nga kontributet dhe pjesërisht nga buxheti i shtetit.

Kolona e dytë mungon në sistemin e pensioneve në RSH.

Kolona e tretë përbëhet nga kursimet vullnetare për pension dhe mundëson në mënyrë të pavarur nga kolona e parë, një të ardhur shtesë për pensionistët bazuar në Ligjin nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit Privat". Kjo kolonë menaxhohet nga shoqëri administruese private dhe të pavarura të licensuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të cilat kryejnë mbledhjen e fondeve nga kontributet e anëtarëve dhe investimin e tyre me qëllim që t'u sigurojnë anëtarëve të ardhura më të larta në moshën e pensionit. Skema mbështetet në parimin e kontributeve të përcaktuara (DC) dhe rreziku i investimit i përket tërësisht anëtarit në Fond.

Anëtarësimi në Fondin Privat të Pensionit Raiffeisen fillon me lidhjen e Marrëveshjes së Anëtarësimit me Shoqërinë Raiffeisen Invest e cila kryen ekskluzivisht organizimin dhe administrimin e fondit të pensionit dhe është përgjegjëse për përmbajtjen e prospektit të këtij fondi. Shoqëria administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar anëtarit të fondit nga veprimet ose mosveprimet e saj apo nëse dokumentet ose informacioni i parashikuar në prospekt përmbajnë të dhëna dhe informacione të pavërteta ose të paplota.

Shoqëria Raiffeisen Invest garanton se aktivet e fondit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të saj dhe se aktivet e fondit të pensionit veçohen nga aktivet e shoqërisë administruese dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të shoqërisë administruese dhe se fondi nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit.

Aktivitetet e fondit me pjesëmarrje të hapur janë tërësisht të ndara nga aktivet e tjera të administruara nga shoqëria administruese.

Pasqyra e lëndës

1	Informacion mbi Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen	6
1.1	Emri i fondit, monedha bazë e fondit dhe lloji i fondit	6
1.2	Data e themelimit të fondit	6
1.3	Vendimi për licencimin e fondit	6
1.4	Adresa e shoqërisë administruese	6
1.5	Vendi ku anëtarit mund të pajset me kopje të prospektit, raportet financiare të ndërmjetme, raportin vjetor të audituar ose botime të tjera të publikuara nga shoqëria administruese	6
1.6	Mënyra e publikimit të prospektit, raporteve financiare të ndërmjetme dhe raportit vjetor të audituar	7
1.7	Ndryshimet e rëndësishme të prospektit të fondit dhe publikimi i tyre	7
1.8	Informacion për audituesin ligjor të fondit	7
1.9	Anëtarësimi në fond	7
1.9.1	Kontrata e anëtarësimit	7
1.9.2	Refuzimi i anëtarësisë	8
1.9.3	Ndërprerja e anëtarësisë	8
1.9.4	Përfundimi i anëtarësisë	8
1.9.5	Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni	8
1.9.6	Pagesa e kontributeve në fondin e pensionit	9
1.9.7	Konvertimi i kontributeve në llogarinë personale të anëtarit në kuota	9
1.10	Pagesa e pensionit	10
1.10.1	Kriteret e parashikuara në ligj për përfitimin e pensionit	10
1.10.2	Pagesa e pensionit në mënyrë të menjëhershme	10
1.10.3	Pagesa e pensionit në mënyrë periodike	10
1.10.4	Pagesa e pensionit përmes shoqërisë së sigurimit të jetës	11
1.11	Tërheqja e parakohshme	11
1.11.1	Penaliteti i tërheqjes së parakohshme	11
1.12	Informacion për regjimin tatimor të zbatueshëm për fondin e pensionit	12
1.12.1	Regjimi tatimor i fondit të pensionit	12
1.12.2	Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët	12
1.12.3	Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi	12
1.12.4	Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtarit i cili ka përfituar nga lehtësitë tatimore gjatë fazës kontributive	12
1.12.5	Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtarit i cili nuk ka përfituar nga lehtësitë tatimore gjatë fazës kontributive	13
1.13	Të drejtat që burojnë nga anëtarësia në fond	13
1.13.1	E drejta për informim dhe transparencë	13
1.13.2	E drejta për pension	13
1.13.3	E drejta për transferim	13
1.13.4	E drejta për lehtësi fiskale	13
1.13.5	E drejta për privatësi	14
1.13.6	E drejta për të trashëguar	14
1.13.7	E drejta e mbrojtjes së aktiveve	14
1.13.8	E drejta për ndërprerjen e anëtarësisë	14
1.13.9	E drejta për tërheqje të parakohshme	14
1.13.10	E drejta për kthim nga investimi	14
1.14	Informacion për të gjitha komisionet që mbahen nga shoqëria administruese nga aktivet e fondit të pensionit privat, si dhe informacion për mënyrën e mbajtjes dhe pagesës së tyre	14

1.14.1	Komisioni i administrimit	14
1.14.2	Komisioni i transferimit	15
1.14.3	Tarifa të tjera	15
1.15	Metodologjia e vlerësimit të vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimit të kuotës	16
1.16	Regjistri i pronësisë së fondit	17
1.17	Bashkimi dhe ndarja e fondit	17
1.17.1	Bashkimi i fondeve	17
1.17.2	Ndarja e fondeve	17
1.18	Viti financiar	17
1.19	Informacion plotësues	18
1.19.1	Etika dhe konflikti i interesit	18
1.19.2	Kujdesi	18
1.19.3	Ankesat	18
2	Politika e investimit	18
2.1	Instrumentet e lejuara të investimit	18
2.2	Objektivat e investimit	18
2.3	Strategjia e investimit dhe shpërndarja e aktiveve	19
2.4	Kufizimet e investimit	20
2.5	Huamarrja	20
2.6	Aprovimi dhe ndryshimi i politikës së investimit	20
2.7	Politika e ekzekutimit më të mirë	21
2.7.1	Faktorët e ekzekutimit	21
2.7.2	Përzgjedhja e ndërmjetësve/ palëve	21
2.7.3	Vendet e ekzekutimit	21
3	Rreziqet që lidhen me investimet dhe strukturën e aktiveve të fondit	22
4	Të dhëna historike	24
4.1	Të dhëna mbi fondin në datë 31 dhjetor 2024	24
4.2	Të dhëna mbi performancën e fondit	25
5	Skenarë të ndryshëm për pensionin	25
6	Të dhëna për shoqërinë administruese	28
6.1	Forma ligjore	28
6.2	Fondet nën administrim	28
6.3	Organet drejtuese të shoqërisë administruese	28
6.3.1	Asambleja e aksionarëve	28
6.3.2	Këshilli i administrimit	28
6.3.3	Komiteti i investimeve	30
6.3.4	Administratorët ekzekutivë	30
6.3.5	Personeli kyç i shoqërisë	30
6.3.6	Struktura organizative e shoqërisë administruese	31
6.4	Delegimi i disa funksioneve të shoqërisë administruese tek palët e treta	31
6.4.1	Delegimi i disa funksioneve tek Raiffeisen Bank sh.a	31
6.4.2	Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve	32
6.4.3	Likuidimi vullnetar dhe i detyrueshëm i shoqërisë administruese	32
6.5	Informacion për audituesin ligjor të shoqërisë administruese	32
7	Informacion lidhur me depozitarin	33
7.1	Konflikti i interesit	33

Përkufizime të termave kryesorë

Aktive – Tituj, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të fondit të pensionit;

Anëtar – Individ, i cili bashkohet fondit të pensionit në bazë të një kontrate anëtarësimi me shoqërinë administruese, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në fondin e pensionit dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga fondi i pensionit;

Agjent i fondit të pensionit – Personi juridik, i krijuar si institucion financiar dhe i regjistruar nga Autoriteti për të promovuar fondin e pensionit dhe për të ofruar kontrata anëtarësimi në fondin e pensionit në emër të shoqërisë administruese;

Autoriteti – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);

Auditues i jashtëm – Personi juridik në cilësinë e një shoqërie auditimi, me qëllim auditimin e pavarur të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara;

Depozitari (banka kujdestare) – Banka e licensuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për aktivet e Fondit të pensionit;

Diversifikim i portofolit – Investim i aktiveve të Fondit në instrumente të ndryshëm financiare, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga investimi;

Fond pensioni privat ("fond pensioni") – Një grup i veçuar aktivesh pa personalitet juridik, i miratuar nga Autoriteti dhe i administruar nga shoqëria administruese, për llogari të anëtarëve të fondit. Fondi i pensionit privat mund të jetë me pjesëmarrje të hapur ose me pjesëmarrje të mbyllur;

Fond pensioni me pjesëmarrje të hapur – Fondi i pensionit i krijuar nga shoqëria administruese, anëtar i të cilit mund të jetë çdo individ, përfshirë punëmarrësit e punëdhënësit, i cili zgjedh të kontribuojë në fondin e ofruar nga shoqëria administruese, pa krijuar një fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur;

Huadhënia e titujve – Në lidhje me fondin e pensionit privat nënkupton dhënien hua të instrumenteve financiare nga njëra palë te një palë tjetër sipas një norme të përcaktuar interesi dhe sipas një afati kohor të përcaktuar;

Këshilli i Administrimit – Organ i shoqërisë administruese me përgjegjësi kryesore për administrimin dhe mbikëqyrjen;

Komision transferimi – Komisioni që anëtar i paguan shoqërisë administruese në momentin e transferimit të aktiveve nga një fond pensioni privat i një shoqërie administruese në një fond pensioni privat të një shoqërie tjetër administruese;

Komisioni vjetor i administrimit – Tarifa periodike që i paguhet shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat, e përlogaritur në bazë të një përqindjeje vjetore sipas vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit;

Kthim nga investimi – Rezultati që merret nga investimi i aktiveve dhe fitimi nga kapitali;

Kontribues – Anëtar i një fond pensioni, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë, i cili paguan kontributet e pensionit në llogarinë e pensionit të anëtarit të Fondit të pensionit;

Kuotë pensioni – Pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e aktiveve të Fondit të pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të aktiveve të Fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të Fondit të pensionit, gjithmonë, është e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të këtij Fondi pensioni;

Manaxher i fondit – Personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e portofolit të investimit të fondit;

Marrëveshje e riblerjes (Repo) – Marrëveshje ku shitësi i letrave me vlerë, pranon t'i blejë ato përsëri në një kohë dhe me çmim të paracaktuar;

Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo) – Blerja e letrave me vlerë për t'i rishitur ato më pas në një datë të caktuar me një çmim më të lartë;

Pagesat e pensionit – Pagesat në para, në formë pensioni, të kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, të vlerësuara me çmimin e kuotës të ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje;

Përfitues – Është individ, i cili merr përfitime pensioni sipas dispozitave ligjore në fuqi;

Periudhë e përfitimit të kontributeve (vesting period) – Konsiderohet periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi.

Persona kyç – Individët të cilët përfaqësojnë shoqërinë administruese dhe ushtrojnë funksione drejtuese, përfshirë administratorin dhe anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë dhe në rastin e depozitarit drejtuesi i shërbimeve të depozitarit.

Portofoli i investimit – Tërësia e investimeve të kryera me aktivet e Fondit;

Prospekt – Dokumenti i bërë publik, që përmban informacionin më të rëndësishëm për fondin e pensionit privat, si politika e investimit, politika e administrimit të rrezikut, tarifat etj;

Shoqëri administruese e fondit të pensionit privat (në vijim "shoqëri administruese") – Shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe e licensuar nga Autoriteti për të administruar një ose disa fonde të pensionit privat;

Tituj – Tituj ose instrumente financiare të negociueshme që emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Mund të jenë tituj të pjesëmarrjes në kapital, tituj borxhi, aksione ose kuota të fondit të investimeve ose fondit të pensioneve;

Transferimi i aktiveve – Transferimi i aktiveve nga një fond pensioni në një fond tjetër pensioni, i administruar nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese;

Vlera neto e aktiveve për kuotë – Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit e pjesëtuar me numrin e kuotave në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve;

Vlera neto e aktiveve – Vlera e agreguar e aktiveve të fondit të pensionit pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve në momentin e llogaritjes.

Informacion mbi fondin e pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Raiffeisen

1.1 Emri i fondit, monedha bazë e fondit dhe lloji i fondit

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të hapur Raiffeisen (në vijim "Fondi") administrohet nga Raiffeisen Invest sh.a -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive(në vijim "Shoqëria Administruese").

Monedha bazë e fondit është Lekë.

Kontributet në fond, dhe pagesat e pensionit privat kryhen në monedhën lekë.

Kontributi minimal në Fond është 1000 lekë.

1.2 Data e themelimit të fondit

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të hapur Raiffeisen është themeluar në 18 Tetor 2010.

Ky fond është trashëguar nga Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen sh.a. i cili është licencuar në Korrik të vitit 2005 nën emrin Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë sh.a dhe u bë pjesë e grupit Raiffeisen, në Janar të vitit 2009.

1.3 Vendimi për licencimin e fondit

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin nr. 107, datë 18/10/2010, nën administrimin e Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Privat Raiffeisen sh.a. Në të njëjtën datë është miratuar edhe Prospekti i parë i Fondit. Fondi ka filluar veprimtarinë më datë 18/10/2010. Çmimi i parë i kuotës ishte 1000 lekë.

1.4 Adresa e shoqërisë administruese

Shoqëria administruese ka selinë e saj në adresën Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, Shqipëri.

1.5 Vendi ku anëtari mund të pajiset me kopje të prospektit, raportet financiare të ndërmjetme, raportin vjetor të audituar ose botime të tjera të publikuara nga shoqëria administruese

Shoqëria administruese vendos në dispozicion të anëtarit prospektin e fondit ku janë përcaktuar rregullat e fondit, pa pagesë, në formë të shtypur në letër, përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, pranë degëve të Raiffeisen Bank Sh.a. (Agjenti i fondit të pensionit).

Prospekti i Fondit është i disponueshëm për anëtarin edhe pranë zyrave qendrore të shoqërisë administruese në adresën Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, si dhe publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese www.raiffeisen-invest.al.

Me kërkesë të anëtarit, nëpërmjet një shkresë zyrtare ose elektronike (posta elektronike e shoqërisë është invest@raiffeisen.al) ky dokumentacion dërgohet pa pagesë në postën elektronike të tij.

Raportet financiare të ndërmjetme, raporti vjetor i audituar si dhe pasqyrat financiare, i vihen në dispozicion anëtarit, sipas kërkesës dhe pa pagesë pranë selisë së shoqërisë administruese, Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë ose në postën elektronike të tij. Shoqëria administruese gjithashtu publikon në faqen e internetit raportet vjetore dhe pasqyrat financiare më të fundit për fondin e pensionit.

Shoqëria administruese publikon çdo ditë çmimin e kuotës së fondit të pensionit dhe vlerën neto të aktiveve pas konfirmimit nga depozitari.

Nëpërmjet web portal-it të saj, shoqëria administruese i siguron anëtarit akses në çdo kohë në llogarinë e tij individuale të pensionit.

Në mënyrë që të sigurohet informacioni i nevojshëm dhe në kohë, anëtari ka detyrimin të pajisë shoqërinë administruese me të dhënat e tij të kontaktit si: adresë, adresë elektronike, nr. tel. etj. si dhe ta njoftojë për çdo ndryshim të tyre.

1.6 Mënyra e publikimit të prospektit, raporteve financiare të ndërmjetme dhe raportit vjetor të audituar

Prospekti, raportet financiare të ndërmjetme dhe raporti vjetor i audituar publikohen në faqen zyrtare të shoqërisë administruese.

1.7 Ndryshimet e rëndësishme të prospektit të fondit dhe publikimi i tyre

Ndryshime të rëndësishme të prospektit të fondit të pensionit janë ndryshimet që ndryshojnë qëllimin ose natyrën e fondit, që mund të kenë pasojë të rëndësishme, të padëshirueshme për anëtarin e fondit, që ndryshojnë profilin e rrezikut të fondit ose mënyrën e pagesës. Në këto ndryshime përfshihen:

- rritja e tarifave të administrimit, komisionit të transferimit, si dhe përfshirja e një komisioni të ri të padeklaruar më parë në prospekt, brenda kufijve të përcaktuar në ligj;
- ndryshimi i objektivave të investimit të fondit dhe rreziqeve të lidhura me investimet e parashikuara të fondit;
- ndryshimi i profilit të rrezikut të fondit të pensionit ose aftësisë mbajtëse të rrezikut.

Të gjitha këto ndryshime janë objekt i miratimit nga Autoriteti.

Ndryshimet e rëndësishme të Prospektit, publikohen në faqen zyrtare të shoqërisë si dhe u njoftohen brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së miratimit nga Autoriteti, me postë normale ose me postë elektronike të gjithë anëtarëve të fondit. Brenda 30 ditëve pune nga data e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit privat pa paguar komision transferimi.

1.8 Informacion për audituesin ligjor të fondit

Audituesi ligjor i Fondit është:

RSM Albania Sh.p.k., me seli në

adresën: Rruga Skënder Luarasi, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, Tiranë, Shqipëri,

Përfaqësuar nga: Elona Bisha (Administrator) - E-mail: Elona.bisha@rsm.al

Personi kontaktues sekondar: Fatian Devija (Partner) – E-mail: fatian.devija@rsm.al

Website: <https://www.rsm.global/albania>

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

1.9 Anëtarësimi në fond

Anëtarësimi i një individi në Fondin e pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur Raiffeisen fillon me nënshkrimin e kontratës së anëtarësimit me Shoqërinë administruese dhe kryerjen e pagesës së kontributit të parë në llogarinë e Fondit pranë Bankës Depozitare.

Në rastin kur një apo grup punëdhënësish përfshin punëmarrësit në një Fond pensioni me pjesëmarrje të hapur anëtarësimi fillon me nënshkrimin e një kontrate midis Punëdhënësit dhe Shoqërisë Administruese si dhe deklaratës së pranimi nga çdo punëmarrës pjesëmarrës në fond, shoqëruar me kryerjen e pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit pranë Bankës Depozitare.

Procesi i anëtarësimit në Fond mund të kryhet pranë çdo dege të Raiffeisen Bank sh.a, e cila vë në dispozicion të anëtarit të mundshëm një staf të trajnuar dhe të autorizuar për shitje nga shoqëria administruese.

1.9.1 Kontrata e anëtarësimit

Shoqëria administruese publikon në faqen e internetit kontratat tip të anëtarësimit dhe deklaratën e pranimi të pjesëmarrjes për punëmarrësit e një punëdhënësi.

Kontrata e anëtarësimit ose deklarata e pranimi të pjesëmarrjes nënshkruhet vetëm pasi anëtari i mundshëm është njohur me Prospektin e fondit të pensionit privat dhe është informuar për të gjitha tarifat që do t'i ngarkohen, opsionet e pagesës së pensionit me lindjen e së drejtës për pension, kushtet kur lind e drejta e pensionit, kushtet për tërheqjen nga fondi apo transferimin e aktiveve, rreziqet e investimit, si dhe mënyra dhe afatet për njoftimin/informimin e tij.

Me nënshkrimin e kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimi të pjesëmarrjes Shoqëria Administruese regjistron anëtarin në regjistrin e anëtarëve, hap një llogari personale në emër të anëtarit në fond dhe pas mbërritjes së pagesës së kontributit në llogarinë e fondit, bën konvertimin e tij në kuota.

Gjithashtu, Shoqëria Administruese pajis Anëtarin me kredencialet përkatëse, për të aksesuar në çdo kohë llogarinë e tij në Fondin e Pensionit.

Anëtarësimi në fondin e pensionit mund të bëhet edhe nëpërmjet një kontrate të lidhur në largësi me mjete elektronike në përputhje me kuadrin rregullator.

Në këtë rast, anëtari do të ketë akses në dokumentacionin e plotë të fondit, i cili përfshin Prospektin dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga legjislacioni në fuqi. Këto, do të paraqiten si fusha të detyrueshme për t'u lexuar nga anëtari përpara marrjes së një vendimi për anëtarësim.

Procesi i anëtarësimit digjital do të projektohet në mënyrë të tillë që të sigurojë zbatimin e kërkesave ligjore për identifikimin elektronik si dhe transparencë të plotë ndaj anëtarëve, duke garantuar që ata të jenë të pajisur me gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të informuara.

1.9.2 Refuzimi i anëtarësisë

Shoqëria administruese mund të refuzojë lidhjen e kontratës së anëtarësisë nëse ekziston dyshimi se mund të kryhet vepra penale e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit apo nëse ekziston një shkak i ligjshëm ose një vendim gjykatë, që pengon shoqërinë administruese të pranojë anëtarin në Fond. Kur shoqëria administruese refuzon lidhjen e kontratës së anëtarësimit në fond, duhet të informojë anëtarin e mundshëm për arsyet e refuzimit, përveçse kur legjislacioni në fuqi nuk e lejon.

1.9.3 Ndërprerja e anëtarësisë

Anëtari i fondit brenda 30 ditëve kalendrike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit mund të zgjidhë pa penalitete kontratën e anëtarësimit, duke njoftuar me shkrim ose postë elektronike shoqërinë administruese.

Brenda 5 ditëve pune nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim të anëtarit, shoqëria administruese ka detyrimin t'i kthejë atij vlerën e kontributeve të paguara në llogari, përfshirë kthimin nga investimi, duke zbritur tarifën e administrimit për atë periudhë.

1.9.4 Përfundimi i anëtarësisë

Anëtarësimi në fond përfundon kur të jenë shlyer dhe kuotat e fundit në llogarinë e anëtarit në fondin e pensionit apo kur të jetë kryer transferimi i vlerës së plotë të aktiveve në një fond pensioni të administruar nga një tjetër shoqëri administruese apo në një shoqëri sigurimi jete.

Nëse anëtari, përkohësisht ose përgjithmonë, pushon së kontribuari në fondin e pensionit, ai mbetet anëtar në fondin e pensionit dhe ka të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të fondit të pensionit.

1.9.5 Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni

Anëtari i Fondit ka të drejtë, që, në çdo kohë, të transferojë aktivet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese.

Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, kryhet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga Anëtari. Shuma e transferuar përllogaritet duke shumëzuar numrin e kuotave në llogarinë e anëtarit me çmimin e kuotës të ditës së regjistrimit të kërkesës për transferim.

Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një fond të një shoqërie tjetër administruese, shoqëria administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtari për të transferuar aktivet njofton brenda 5 ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve. Transferimi i aktiveve në Fondin e ri kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë tjetër administruese.

Shoqëria Administruese, brenda 5 ditëve pune nga data e transferimit të llogarisë, informon anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën e aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e zbritura.

1.9.6 Pagesa e kontributeve në fondin e pensionit

Çdo pagesë kontributesh kryhet në llogarinë bankare të Fondit me nr. AL782151 1031 ALL1 0000 0393 3000, të hapur pranë Depozitarit, i cili është Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.

Pagesa e kontributeve bëhet në LEKË nga:

- Çdo individ që është anëtar në Fond, ose nga çdo person tjetër jo anëtar, në emër dhe për llogari të anëtarit;
- Çdo punëdhënës, i cili pasi ka lidhur kontratën me shoqërinë administruese, kontribuon në emër dhe në favor të punëmarrësve të tij.
- Çdo punëdhënës, i cili pavarësisht se nuk ka lidhur kontratë me shoqërinë administruese, kryen pagesën e kontributit për llogari të një punonjësi në Fond.

Mënyrat e pagesës së kontributeve janë si më poshtë:

1. Transfertë nga llogaria e Anëtarit/punëdhënësit pranë Raiffeisen Bank drejt llogarisë së Fondit (pa komision);
2. Transfertë nga llogaria e Anëtarit/punëdhënësit pranë çdo banke të nivelit të dytë (të ndryshme nga Raiffeisen) drejt llogarisë së Fondit, kundrejt komisioneve në fuqi;

Anëtari në Fond, ka të drejtë të autorizojë bankën tek e cila disponon një llogari të vlefshme, për pagesa automatike e periodike. Në rastin kur punëdhënësi anëtarëson punëmarrësit e tij në Fond, ai derdh përveç kontributeve të tij edhe kontributet individuale të punonjësve, duke ia zbritur automatikisht nga paga, pas miratimit të dhënë nga këta të fundit. Pagesat e kontributeve mund të bëhen sipas frekuencës së vendosur nga anëtari i Fondit.

Shënim: Është shumë e rëndësishme që Anëtari në Fond të dijë kodin e kontratës së tij. Ky kod/numër përdoret në përshkrimin e pagesës së kontributeve dhe identifikon përfituesin e çdo pagese kontributesh. Kodi i vihet në dispozicion anëtarit nga shoqëria administruese.

1.9.7 Konvertimi i kontributeve në llogarinë personale të anëtarit në kuota

Pagesat në formë kontributi të bëra në llogarinë personale të anëtarit, si dhe aktivet e transferuara në fond do të shndërrohen në kuota pensioni në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës.

Shembull i blerjes së një kuote pensioni:

Çmimi i kuotës së pensionit në ditën e kontributit: **Lekë 1,000.00**

Kontributi: **Lekë 3,000.00**

Numri i kuotave të anëtarit në Fond: **Lekë 3,000.00/Lekë 1,000.00 = 3 kuota**

Ky transaksion regjistrohet në llogarinë individuale të anëtarit të Fondit e cila mbahet pranë Shoqërisë Administruese Raiffeisen INVEST sha.

Nëse pas disa kohësh çmimi i kuotës do të rritet nga **Lekë 1,000.00 në Lekë 1,050.00**, vlera e aktiveve të anëtarëve në Fond (pasi është zbritur tarifa e administrimit) do të jetë **Lekë 1,050.00 x 3 kuota = Lekë 3,150.00.**

Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në aktivet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të Fondit.

1.10 Pagesa e pensionit

Pagesë pensioni konsiderohet tërheqja e aktiveve të akumuluar në llogarinë e anëtarit kur ai plotëson kushtet e parashikuara në ligj.

Shoqëria administruese do të njoftojë anëtarin 3-muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aktiveve neto në llogarinë e tij të pensionit. Anëtarit ka detyrimin të njoftojë shoqërinë administruese për çdo ndryshim në të dhënat e tij personale përfshirë edhe të dhënat e kontaktit si: adresë fizike/elektronike, nr. tel. etj. Shoqëria administruese nuk është përgjegjëse ndaj çdo pretendimi për mosmarrje njoftimi, në rast se Anëtarit nuk e informon lidhur me përditësimin e të dhënave të kontaktit apo saktësinë e tyre.

1.10.1 Kriteret e parashikuara në ligj për përfitimin e pensionit

Shoqëria Administruese do të ushtrojë edhe veprimtarinë e kryerjes së pagesave të pensionit.

Çdo anëtar i Fondit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e vet, ose pagesat periodike, në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere kur përmbush kushtet e mëposhtme:

1. Kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm që zbatohet për atë anëtar;
2. 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm;
3. Kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Aktivitetet e akumuluar mund të tërhiqen në format e mëposhtme:

- pagesë e menjëhershme
- pagesë periodike e planifikuar
- pagesë përmes shoqërisë së sigurimit të jetës
- duke kombinuar mënyrat e mësipërme

Anëtarit i Fondit është i lirë të zgjedhë mënyrën e tërheqjes së aktiveve nga llogaria e tij personale duke marrë në konsideratë trajtimin fiskal të secilës mënyrë tërheqjeje, siç është përshkruar në pikën 1.12.

1.10.2 Pagesa e pensionit në mënyrë të menjëhershme

Me përmbushjen e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit, anëtarit i fondit ka të drejtë të marrë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij në formën e një pagese të menjëhershme pas një kërkesë me shkrim, drejtuar shoqërisë administruese. Pagesa e menjëhershme mund të jetë e pjesshme ose e plotë.

Shuma e tërhequr për llogaritë duke shumëzuar numrin e kuotave të përcaktuar në kërkesën për tërheqje me çmimin e kuotës të ditës së regjistrimit të kërkesës për tërheqje.

Në rastin e një pagese të menjëhershme në formë të pjesshme, aktivitetet e mbetura të anëtarit në llogarinë e pensionit, investohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha aktivitetet e fondit të pensionit privat.

Shoqëria administruese ka detyrimin që brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës për tërheqje nga anëtarit, të kryejë pagesën e vlerës së kërkuar neto të aktiveve në llogarinë e anëtarit.

1.10.3 Pagesa e pensionit në mënyrë periodike

Me plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit, anëtarit i fondit mund të vendosë të marrë pagesa periodike mujore në formë pensioni të zgjatura në kohë, jo më pak se 2 vjet. Në këtë rast ndërmjet anëtarit të fondit dhe shoqërisë administruese lidhet një kontratë e veçantë për kushtet dhe mënyrat e pagesës së pensionit sipas legjislacionit në fuqi.

Sipas preferencës së anëtarit, shuma e pagesës periodike përcaktohet si numër kuotash ose si vlerë në monedhën LEKË.

Pagesat periodike mujore, në para, të kuotave që gjenden në llogarinë individuale të anëtarit vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së njohjes së detyrimit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar mes palëve.

Shoqëria administruese dërgon urdhër pagesën brenda 3 ditëve pune, nga data e njohjes së detyrimit, për ekzekutimin e pagesës;

1.10.4 Pagesa e pensionit përmes shoqërisë së sigurimit të jetës

Me plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit, anëtari gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij për të blerë një kontratë të sigurimit të jetës në formë "anuiteti" në një shoqëri të sigurimit të jetës.

Shoqëria Administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e anëtarit të fondit dhe merr një konfirmim nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë "anuiteti". Shoqëria administruese transferon vlerën neto të aktiveve për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës tek shoqëria e sigurimit, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit së kërkesës nga anëtari. Vlera neto e aktiveve të transferuara në shoqërinë e sigurimit përlllogaritet duke shumëzuar numrin e kuotave në llogarinë e anëtarit me çmimin e kuotës të ditës së regjistrimit të kërkesës për transferim tek shoqëria e sigurimit të jetës.

Vlera neto e aktiveve në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, e transferuar te shoqëria e sigurimit të jetës duhet të përdoret vetëm për qëllim të blerjes së një kontrate të sigurimit të jetës në formë "anuiteti" të lëshuar nga shoqëria e sigurimit të jetës, e përzgjedhur nga anëtari.

1.11 Tërheqja e parakohshme

Nëse anëtari i Fondit kërkon të tërheqë aktivet e akumuluar në llogarinë e tij individuale pa përmbushur kriteret ligjore për të përfituar pension, kjo konsiderohet tërheqje e parakohshme. Vlera e tërheqjes së parakohshme përlllogaritet duke shumëzuar numrin e kuotave të përcaktuar në kërkesën për tërheqje me çmimin e kuotës të ditës së regjistrimit të kërkesës për tërheqje. Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitetin e tërheqjes së parakohshme i cili llogaritet në raport me kohën e përmbushur nga anëtari në Fond, nga çasti i kontributit të tij të parë e deri në çastin e tërheqjes së parakohshme.

Tërheqja e parakohshme mund të kërkohet nga anëtari i fondit duke u paraqitur pranë një agjenti shitje dhe duke nënshkruar një kërkesë për tërheqje pjesore ose të plotë të aktiveve të akumuluar në llogarinë e tij individuale.

Shoqëria administruese brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së anëtarit, urdhëron depozitarin të kryejë pagesën e aktiveve që do të tërhiqen nga anëtari.

1.11.1 Penaliteti i tërheqjes së parakohshme

Në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit, shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete mbi vlerën neto të aktiveve të tërhequra para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas rastit në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat në fuqi, në momentin e tërheqjes, të cilat do të llogariten në raport me kohëzgjatjen e Anëtarit në Fond, dhe më konkretisht:

- 2% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
- 5% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
- 10% për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
- 15%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.

Për efekt të llogaritjes së penalitetit të tërheqjes së parakohshme, si datë e kontributit të parë do të konsiderohet data e parë e derdhjes së kontributit në fondin e pensionit dhe në rastet e transferimit të aktiveve, data e parë e derdhjes së kontributit në fondin e parë të pensionit.

Kur anëtari zgjedh të hapë një llogari tjetër në një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta shoqëri ose nga një shoqëri tjetër administruese, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rast të tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga ky fond i ri, kohëzgjatja e anëtarësimit do të llogaritet që nga data e derdhjes së kontributit të parë në këtë fond të ri.

1.12 Informacion për regjimin tatimor të zbatueshëm për fondin e pensionit

1.12.1 Regjimi tatimor i fondit të pensionit

Fondi është një grup aktivesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose tatimit mbi vlerën e shtuar.

Gjatë periudhës së administrimit të fondit të pensionit privat nga shoqëria administruuese, kthimi nga investimi dhe fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit.

1.12.2 Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët

Kontributi mujor i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit në një fond pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit.

Blerja e kuotave të fondit dhe shërbimet e ofruara nga depozitari për anëtarët konsiderohen shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, janë të përjashtuar nga tvsh-ja.

1.12.3 Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një fond pensioni privat vlerësohen shpenzim operativ deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vendi, dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i njohur për qëllime të tatimit mbi fitimin.

1.12.4 Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtari i cili ka përfituar nga lehtësitë tatimore gjatë fazës kontributive

1.12.4.1 Trajtimi fiskal i pagesës së pensionit në mënyrë periodike

Nëse anëtari i fondit zgjedh të marrë pagesa periodike mujore në formë pensioni të zgjatura në kohë, jo më pak se 2 vjet, këto të ardhura taten vetëm për kthimin nga investimi, me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale. Kthimi nga investimi, i cili është rezultati që merret nga investimi i aktiveve dhe fitimi i kapitalit, llogaritet për efekt tatimor nga shoqëria administruuese e fondit të pensionit privat, duke përdorur metodën e çmimit mesatar të blerjes së kuotave.

1.12.4.2 Trajtimi fiskal i pagesës së pensionit në mënyrë të menjëhershme

Pagesa e marrë nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, të parashikuar në seksionin 1.10.3, taten e plotë, përfshirë edhe kontributet, me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale.

12.4.3 Trajtimi fiskal i tërheqjes së parakohshme

Tërheqja e parakohshme e aktiveve nga fondi i pensionit taten me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra para kohe, përfshirë kontributet.

12.4.4 Trajtimi fiskal i pagesave në formë trashëgimie

Kur Anëtari në fondin e pensionit ka ndërruar jetë, përfitimet e trashëgimtarëve do të jenë subjekt i tatimit mbi të ardhurat sipas legjislacionit në fuqi.

12.4.5 Trajtimi fiskal i pagesës së pensionit përmes shoqërisë së sigurimit të jetës

Nëse anëtari në fond zgjedh të blejë një kontratë të sigurimit të jetës në formë "të përvitshme" pranë një shoqërie sigurimi të jetës, aktivet e transferuara pranë shoqërisë së sigurimit do të taten vetëm për kthimin nga investimi me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale, njësoj si pagesat periodike në formë pensioni.

1.12.5 Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtari i cili nuk ka përfituar nga lehtësitë tatimore gjatë fazës kontributive

Pavarësisht formës së pagesës së zgjedhur të pensionit, nëse anëtari në Fond nuk ka përfituar nga lehtësitë tatimore gjatë fazës kontributive (kontributet e tij në fondin e pensionit i janë nështruar tatimit mbi të ardhurat personale), pagesa e pensionit do të tatóhet vetëm për kthimin nga investimi, të cilit i bëhet zbritje 10% e detyrimit të tatimit për t'u paguar. Për këtë, anëtari duhet të provojë me dokumentacion tatimin e kursimeve individuale të investuara në fondin e pensionit.

Shënim: Dispozitat fiskale pasqyrojnë situatën aktuale ligjore. Efektet fiskale varen nga situatat personale të Anëtarit dhe mund të jenë subjekt ndryshimesh në të ardhmen. Kështu, vlerësimi fiskal mund të ndryshojë si rezultat i ndryshimeve në legjislacion, vendimeve të gjykatës ose akteve të tjera nënligjore dhe udhëzuese të administratës Tatimore. Për këto arsye, përpara se të blejnë apo shesin kuota në fond, ne i rekomandojmë anëtarët që të këshillohen me një këshilltar fiskal mbi pasojat që mund të kenë sipas situatës së tyre personale.

1.13 Të drejtat që burojnë nga anëtarësia në fond

Të drejtat e anëtarëve në fondin e pensionit privat parashikohen në Ligjin nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat" dhe përfshijnë:

1.13.1 E drejta për informim dhe transparencë

Anëtarët në Fond kanë të drejtë të informohen rregullisht mbi gjendjen e llogarisë së tyre, përfshirë vlerën e kontributeve dhe performancën e investimeve. Nëpërmjet web portal-it të saj, shoqëria administruese i siguron anëtarit akses në çdo kohë në llogarinë e tij individuale të pensionit.

Në rastet kur faqja zyrtare e shoqërisë administruese ka probleme teknike dhe është i pamundur publikimi i të dhënave të Fondit, anëtari mund të informohet për çdo informacion që lidhet me Fondin nëpërmjet e-mail ose telefon bazuar në kërkesën e tij.

Gjithashtu, shoqëria administruese harton një vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit për çdo anëtar të fondit të pensionit privat, i cili përmban informacion të saktë dhe të përditësuar mbi vlerën neto të aktiveve të akumuluar, kthimin nga investimi për periudhën 12-mujore, kontributet e derdhura nga anëtari ose punëdhënësi në emër të anëtarit gjatë 12 muajve të fundit dhe një detajim të kostove ose tarifave të zbritura nga shoqëria administruese. Ky vërtetim i vihet në dispozicion çdo anëtar, pa pagesë, në formë elektronike, një herë në vit.

Përveç vërtetimit për gjendjen e llogarisë së pensionit, shoqëria administruese 3 muaj përpara se anëtari të arrijë moshën për pension duhet ta informojë për vlerësimin aktual të llogarisë individuale, ta pajisë me opsionet për mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe t'i japë udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë.

Raportet periodike financiare të publikuara nga shoqëria administruese sigurojnë transparencë mbi mënyrën sesi administrohen kontributet e anëtarit në Fond.

1.13.2 E drejta për pension

Çdo anëtar i Fondit, me përmbushjen e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit, ka të drejtë të përfitojë nga pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aktiveve në llogarinë e vet, ose nga pagesa periodike, në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere.

Anëtari i Fondit është i lirë të zgjedhë mënyrën e tërheqjes së aktiveve nga llogaria e tij personale.

1.13.3 E drejta për transferim

Anëtarët mund të transferojnë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tyre të pensionit në një fond tjetër pensioni privat, të administruar nga e njëjta shoqëri ose shoqëri administruese e ndryshme, sipas kushteve të përcaktuara në këtë prospekt dhe në kontratat përkatëse.

1.13.4 E drejta për lehtësi fiskale

Anëtari ka të drejtën të përfitojë lehtësi fiskale, sipas dispozitave në fuqi të legjislacionit për tatimin mbi të ardhurat, të parashikuara në seksionin 1.12 të këtij Prospekti.

1.13.5 E drejta për privatësi

Të dhënat personale dhe financiare të anëtarëve mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

1.13.6 E drejta për të trashëguar

Nëse anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjitha aktiveve të veta në Fond, aktivet në llogarinë e tij do t'u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore, që rregullojnë trashëgiminë në RSH.

1.13.7 E drejta e mbrojtjes së aktiveve

Aktivitetet e fondit të pensionit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese. Ato veçohen nga aktivet e shoqërisë administruese dhe Depozitarit dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të tyre.

1.13.8 E drejta për ndërprerjen e anëtarësisë

Anëtari i fondit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit mund të zgjidhë pa penalitete kontratën e anëtarësimit, duke njoftuar me shkrim ose postë elektronike shoqërinë administruese.

1.13.9 E drejta për tërheqje të parakohshme

Anëtari i Fondit ka të drejtë të tërheqë aktivet e akumuluar në llogarinë e tij individuale pa përmbushur kriteret ligjore për të përfituar pension. Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitetin e tërheqjes së parakohshme.

1.13.10 E drejta për kthim nga investimi

Anëtari i Fondit ka të drejtë të kthimit nga investimi. Fondi synon të optimizojë përfitueshmërinë afatgjatë duke minimizuar rrezikun. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se kthimi nga investimi varet nga kushtet e tregut dhe mund të jetë i paqëndrueshëm. Prandaj, kthimet nuk janë të garantuara.

Ecuria e fondit ndikohet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë luhatjet e tregut, kushtet ekonomike dhe performancën e aktiveve në portofolin e tij. Ndërsa shoqëria administruese përdor strategji për të arritur rezultatet më të mira të mundshme, vlera e investimit mund të rritet ose ulet. Anëtari në Fond duhet të pranojë se kthimi nga investimi nuk është i garantuar dhe se performanca e shkuar nuk është tregues i rezultateve të ardhshme.

1.14 Informacion për të gjitha komisionet që mbahen nga shoqëria administruese nga aktivet e fondit të pensionit privat, si dhe informacion për mënyrën e mbajtjes dhe pagesës së tyre

Për të mbuluar kostot e fondit të pensionit, shoqëria administruese zbaton komisionet e mëposhtme:

1.14.1 Komisioni i administrimit

Komisioni vjetor i administrimit të Fondit do të mbahet nga aktivet e Fondit. Ai do të jetë deri në 1,5 % në vit të vlerës neto të aktiveve të Fondit.

Komisioni i administrimit do të llogaritet dhe mbahet në fund të çdo dite. Shoqëria administruese tërheq shumën e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës, brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës.

Shembull i mbajtjes së komisionit të administrimit nga Shoqëria Administruese:

Shembull: Përlllogaritja e komisionit të administrimit		
Investimi i kontributit mujor prej 10,000 lekë		
Kontributi mujor (në lekë)		10,000.00
Interesa të përlllogaritura për një muaj		83.33
a) Kontribut + interesa të përlllogaritura		10,083.33
Kthimi vjetor i investimit 10%		
Kthimi mujor i investimit $10\%/12=0.008333333$	0.008333	
Komisioni i administrimit për vitin 1.5%		
b) Komisioni i administrimit për muajin $1.5\%/12=0.00125$	0.001250	12.60
Vlera neto e aktiveve në fund të muajit (në lekë) (a-b)		10,070.73

Komisioni i administrimit përfshin: tarifën e Depozitarit që mbahet nga banka depozitare, tarifën e Autoritetit, tarifën e auditorit të jashtëm, si dhe çdo kosto tjetër operacionale të lidhur me administrimin e Fondit.

1.14.2 Komisioni i transferimit

Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë aktivet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, nuk do të zbatohet komision transferimi. Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë aktivet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër, të administruar nga një shoqëri tjetër administruese, tarifa e zbatueshme që mbulon koston e transferimit do të jetë deri në nivelin 0.5% të shumës së transferuar.

Tarifa e transferimit nuk do të zbatohet në rastet kur shoqëria administruese merr vendime që mund të kenë pasoja të rëndësishme për anëtarin e fondit, të tilla si ato të parashikuara në seksionin 1.7 të këtij prospekti. Në të tilla raste, shoqëria administruese njofton anëtarin me postë normale ose me postë elektronike si dhe i publikon ndryshimet në faqen zyrtare të saj. Brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit pa paguar komision transferimi.

1.14.3 Tarifa të tjera

Përveç tarifave të sipërpërmendura, anëtari i Fondit është i detyruar që të kompensojë shoqërinë administruese për të gjitha shërbimet shtesë që i janë ofruar sipas kërkesës së tij. Këtu përfshihet kostoja e dërgimit të vërtetimeve shtesë mbi llogaritë individuale me kërkesën e veçantë të anëtarit, shpenzimet postare, shpenzime të ndryshme bankare etj.

Çdo rritje e komisioneve të zbatuara nga Shoqëria Administruese brenda kufirit të përcaktuar në ligj do t'u njoftohet anëtarëve të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

Shënim: Prospekti përshkruan vetëm tarifatat të cilat aplikohen nga Shoqëria Administruese. Këtu nuk përfshihen komisionet që mund të aplikojnë bankat e nivelit të dytë për kryerjen e transaksioneve për pagesën e kontributeve në Fond, ose në rastin e tërheqjes së aktiveve nga Fondi (tërheqje e parakohshme, transferim, ose tërheqje kur plotëson kushtet për përfitimin e pensionit).

1.15 Metodologjia e vlerësimit të vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimit të kuotës

Metodologjia e vlerësimit të aktiveve të fondit të pensionit miratohet nga Shoqëria Administruese dhe nga Depozitari.

Shoqëria Administruese llogarit vlerën totale të aktiveve të Fondit të Pensionit, përllogarit/rregjistron detyrimet e tij dhe llogarit vlerën neto të aktiveve, si edhe vlerën neto të aktiveve për kuotë, dhe është përgjegjëse për saktësinë e tyre. Këto llogaritje bëhen në bazë ditore. Depozitari kontrollon dhe konfirmon llogaritjen e këtyre vlerave dhe është përgjegjës për saktësinë e tyre. Metoda e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat" dhe rregulloreve në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Mbështetur në sa më sipër:

- Portofoli i titujve për tregtim dhe/ose i vlefshëm për shitje do të rivlerësohet çdo ditë pune, duke zbatuar çmimin më të fundit të tregut për çdo titull i cili tregtohet aktivisht në Bursë apo tregun e rregulluar.
- Në kushtet e një tregu jo-aktiv të titujve, rivlerësimi bëhet në bazë të një metodologjie të dakortësuar me Depozitarin, e cila mbështetet në yield-in deri në maturim. Ky i fundit llogaritet me metodën e interpolimit linear sipas yield-eve më të fundit të ankandeve të bonove të thesarit apo obligacioneve dhe ditëve të mbetura deri në maturim të titullit. Yield-it deri në maturim mund t'i shtohet një spread i cili përcaktohet nga Shoqëria Administruese dhe Depozitari.
- Vlerësimi i investimeve të klasifikuara si aktive të mbajtura deri në maturim, do të kryhet me metodën e kostos së amortizuar në përputhje me Metodologjinë e vlerësimit të dakordësuar me Depozitarin.
- Kuotat e fondeve të investimit do të rivlerësohen me vlerën neto të aseteve për kuotë të fondit përkatës, sipas çmimit zyrtar të disponueshëm në ditën e vlerësimit. Në rastin kur vlera neto e aseteve për kuotë nuk është publikuar ose nuk është e disponueshme në ditën e vlerësimit, kuotat e investuara në fondet e tjera të investimit do të rivlerësohen me çmimin më të fundit të publikuar për atë fond.
- Të ardhurat e interesit nga depozitat do të llogariten në bazë ditore, por pagesa do të bëhet në datën e maturimit të depozitës. Baza për llogaritjen e interesit është 365 ditë, dhe interesi fillon në datën e emetimit siç është rënë dakort në transaksion. Çdo depozitë me datën e emetimit T dhe maturitet në datën N, do të gjenerojë interes nga data T deri në datën (N-1), por pagesa e interesit nga pala tjetër do të jetë në datën N.
- Marrëveshjet e riblerjes vlerësohen nga dita e fillimit të transaksionit, në mënyrë që titujt që janë objekt, të vazhdojnë të vlerësohen në përputhje me rregullat e zbatueshme të llojit të titullit, ndërsa pasivet për fondet e mjeteve monetare të marra vlerësohen përmes llogaritjes së normës së interesit. Marrëveshjet e anasjellta të ri-blerjes vlerësohen nga dita e fillimit të transaksionit, njësoj si depozitat, përmes llogaritjes ditore të interesit. Baza e llogaritjes së interesit është 365 ditë.

Vlera e kuotës së Fondit në ditën e vlerësimit (T-1) përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të Fondit në lekë të asaj dite (T-1) me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë (T-1). Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (T-1), llogaritet duke i shtuar numrit të përgjithshëm të kuotave në ditën para ditës së vlerësimit (T-2) numrin e kuotave të blera në ditën e vlerësimit (T-1) dhe duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit (T-1).

Vlera Totale e Aseteve në ditën (T-1) - detyrimet pas rillogaritjeve

Çmimi FINAL = _____

Nr. i kuotave në ditën (T-1)

Dita e vlerësimit të aktiveve të Fondit (T-1) do të jetë një ditë para ditës (T) gjatë së cilës bëhet llogaritja e vlerës neto të aktiveve për kuotë. Depozitari ka detyrimin që të informojë AMF-në në lidhje me përllogaritjen e vlerës neto të aktiveve të Fondit dhe çmimit për kuotë çdo ditë.

1.16 Regjistri i pronësisë së fondit

Kuotat e fondit të pensionit janë të dematerializuara dhe mbahen në formë elektronike në regjistrin e pronësisë së fondit i cili krijohet dhe mirëmbahet nga Shoqëria Administruese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Depozitari i fondit të pensionit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese në lidhje me këtë regjistër është i saktë dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

1.17 Bashkimi dhe ndarja e fondit

Fondi i pensionit privat mund të ndahet në dy ose më shumë fonde ose mund të bashkohet me dy ose më shumë fonde të tjera me miratim të Autoritetit.

1.17.1 Bashkimi i fondeve

Bashkimi i fondeve të pensionit kryhet me transferim të një fond ekzistues ose nëpërmjet krijimit të një fondi të ri si më poshtë:

- Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi/disa fondeve të pensionit (fond transferues) që bashkohen i kalojnë një fondi pensioni ekzistues (fond marrës). Anëtarët e fondeve të pensionit, pjesëmarrëse në bashkim, marrin kuotat në fondin marrës dhe fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim prishen;
- Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi/disa fondeve që bashkohen (fond transferues) i kalojnë një fondi pensioni marrës të krijuar rishtazi, anëtarët në fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në fondin e pensionit marrës dhe fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim prishen.
- Pas bashkimit, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit transferues.
- Vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtari në fondin marrës, pas ndryshimit të statusit të fondit si rezultat i bashkimit, duhet të jetë e barasvlershme me vlerën totale të kuotave që anëtari zotëronte në fondin transferues përpara ndryshimit të statusit.
- Shoqëria administruese që administron fondin pas bashkimit do të vazhdojë të gjitha marrëdhëniet juridike që shoqëria administruese e fondit transferues kishte në emër dhe për llogari të fondit transferues.

1.17.2 Ndarja e fondeve

Ndarja e fondit të pensionit privat kryhet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi pensioni transferohen në dy ose më shumë fonde marrëse dhe fondi transferues prishet. Fondi i pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Raiffeisen mund të ndahet në vetëm dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur. Pas realizimit të ndarjes, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit që ndahet. Vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtari në fondin marrës, pas ndryshimit të statusit të fondit si rezultat i ndarjes, duhet të jetë e barasvlershme me vlerën totale të kuotave që anëtari zotëronte në fondin e ndarë përpara ndryshimit të statusit.

1.18 Viti financiar

Viti financiar i fondit do të jetë viti kalendarik, që fillon në 1 Janar e përfundon në 31 Dhjetor.

1.19 Informacion plotësues

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikat më të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë pranë Raiffeisen Invest sh.a. ose në çdo degë të Raiffeisen Bank sh.a. se ky është versioni më i fundit, dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

1.19.1 Etika dhe konflikti i interesit

Punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aktiveve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal, i cili mund të jetë në konflikt me administrimin e investimeve në mënyrën e duhur, apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

1.19.2 Kujdesi

Administrimi i portofolit do të bëhet duke implementuar "Rregullin e personit të kujdesshëm". Ky rregull detyron administruesin e fondit që të veprojë dhe investojë me të njëjtin gjykim, kujdes e mençuri, me të cilin do të vepronte një person i kujdesshëm që po administron aktivet e tij, jo për motive spekulimi, por për një motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondi do të administrohet me profesionalizëm, të denjë për besimin e publikut.

1.19.3 Ankesat

Çdo Ankesë mund të dërgohet me shkrim në adresën e shoqërisë administruese, tek Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, Shqipëri. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe do t'u jepet një përgjigje brenda 2 javëve nga data e mbërritjes së tyre.

02

Politika e investimit

2.1 Instrumentet e lejuara të investimit

Në përputhje me legjislacionin për fondet e pensionit privat, dhe në përputhje me objektivat dhe politikën e investimit të fondit, instrumentet financiare të lejuara për investim të aktiveve janë të renditura si më poshtë:

- Tituj borxhi të emetuar ose të garantuar nga Republika e Shqipërisë;
- Tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar.
- Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar për tregtim në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend të OECD-së, me kusht që përzgjedhja e tregut të rregulluar të jetë parashikuar në kontratën ose prospektin e fondit të pensionit.
- Mjete monetare dhe depozita në banka të licensuara në Republikën e Shqipërisë dhe/ose vendet e OECD-së.
- Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, me përjashtim të fondeve të investimeve alternative.
- Instrumente financiare derivative vetëm për rastet e mbrojtjes nga rreziku i investimit.

2.2 Objektivat e investimit

Objektivi i investimit i Fondit të Pensionit është optimizimi i përfitueshmërisë në terma afatgjatë duke synuar sigurinë e investimit dhe minimizimin e rrezikut, me qëllimin për të siguruar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës së pensionit.

Objektivat kryesore të Fondit sipas rradhës së prioriteteve renditen si më poshtë:

- **Siguria** – Të gjitha vendimet për investime do të ndërmerren në mënyrë të tillë që të sigurojnë ruajtjen e principalit në të gjithë portofolin.

- **Likuiditeti** – Portofoli i investimeve duhet të mbetet mjaftueshëm likuid për të plotësuar të gjitha kërkesat / detyrimet e kërkesave për përfitime . Menaxhimi i duhur i likuiditetit është po aq i rëndësishëm për qëllimet e përmbushjes së kërkesave për shlyerje (terheqjeve të parakohshme/ pensione), si dhe për menaxhimin e flukseve hyrëse në përputhje me objektivat e përgjithshme të investimit.
- **Kthimi nga investimi** – Portofoli i investimeve do të ndërtohet nga obligacione afatgjatë të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me synimin e maksimizimit të fitimit të kushtëzuar nga kufijtë e rrezikut dhe likuiditetit.

2.3 Strategjia e investimit dhe shpërndarja e aktiveve

Aktivet e Fondit do të investohen duke respektuar parimet e sigurisë afatgjatë, diversifikimit të portofolit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm, në kontekstin e arritjes të një kthimi të përshtatshëm dhe afatgjatë nga investimi, për sigurimin e aktiveve dhe të ardhurave në moshën e pensionit, gjithmonë, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Fondi synon të ketë një portofol të përqëndruar kryesisht në tituj borxhi afatgjatë të emtuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Fondi mund të investojë deri në 100% të aktiveve të tij në tituj borxhi qeveritar, të emtuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Cash-i mund të mbahet në bankat dhe institucionet e tjera të mëdha financiare si depozitë afat shkurtër ose transaksione të marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes me afat maturimi maksimumi deri në një vit, me qëllimin për të mbuluar nevojat e likuiditetit afatshkurtër të Fondit, duke përmbushur edhe detyrimet ligjore ndaj investitorëve brenda afateve të përcaktuara.

Transaksionet e marrëveshjeve të Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes kryhen vetëm pasi është nënshkruar një marrëveshje kuadër mes shoqërisë administruese dhe palës tjetër. Në transaksionet e marrëveshjeve të Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes përdoren si kolateralë tituj të transferueshëm, të tregtueshëm në tregje të rregulluara dhe që konsiderohen asete likuide të cilësisë së lartë.

Përdorimi i marrëveshjeve të Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes mund të shoqërohet me risqe të tillë si risk i palës tjetër që nuk shlyen detyrimet në kohë, risk i tregut për shkak të ndryshimit që mund të pesojë vlera e kolateralit, risk i kredisë në lidhje me kolateralin. Për tu mbrojtur nga risku i palës tjetër do të zbatohen kushtet e marrëveshjes së nënshkruar. Kolaterali mbahet në një llogari të veçantë në bankën kujdestare / nënkujdestare dhe për tu mbrojtur nga risku i tregut aplikohen marzhe të tillë si "haircuts" mbi vlerën e kolateralit.

Në lidhje me Horizontin e rekomanduar të Investimit, Anëtarët e fondit të Pensionit rekomandohen të kenë një horizont sa më të gjatë qëndrimi në fond, mundësisht deri në moshën e pensionit, për të përfituar një kthim maksimal nga investimi.

Në mënyrë që të arrijë objektivat kryesorë të investimit, fondi ndjek një strategji, e cila bazohet në një analizë të gjerë të tregut dhe përfshin:

- Administrim të efektshëm të portofolit të investimit në mënyrë që të gjenerojë kthim dhe vlerësim të aktiveve.
- Strukturë konservative të portofolit të titujve, e përbërë kryesisht nga instrumente borxhi të emtuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- Përzgjedhje e llojit të obligacioneve, duke u bazuar në pritshmërinë mbi normën dhe kohëzgjatjen.
- Mbajtjen e një pjese të aseteve të fondit në instrumenta financiarë, që mund të konvertohen lehtësisht në likuiditet.

Për të arritur objektivat e tij afatgjatë, fondi synon të implementojë kufijtë e mëposhtëm në lidhje me shpërndarjen e aktiveve të Fondit.

Shpërndarja e aktiveve		
Instrumenti	Shpërndarja e synuar e aktiveve*	Maksimum
Tituj të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	95%	100%
Tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar.	0%	30%
Depozita bankare, marrëveshje të anasjellta të riblerjes, cash dhe ekuivalentë cash-i	5%	100%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar për tregtim në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend të OECD-së.	0%	100%
Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, me përjashtim të fondeve të investimeve alternative.	0%	30%

**Shpërndarja e synuar e aktiveve tregon se fokusi i investimit do të jetë në tituj borxhi të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Shpërndarja e synuar e aktiveve mund të ndryshojë në varësi të kushteve të tregut. Anëtar i në Fond duhet të ketë parasysh që shpërndarja e synuar e aktiveve është vetëm orientuese dhe jo detyrues mund të arrihet. Kufizimet e shpërndarjes paraqesin kufij të sipërm, mbi të cilët Shoqëria Administruese nuk do të kryejë investime në një kategori të caktuar aktivesh .*

2.4 Kufizimet e investimit

Aktivët e fondit nuk mund të investohen në:

1. aksione, obligacione dhe tituj të tjerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera të rregulluara;
2. metale të çmuara apo të ekspozohen ndaj bursave të mallrave të tjerë
3. aktive fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si antika, punime arti, mjete motorike etj;
4. tituj ose instrumente të tregut të parasë, të emetuar nga:
 - a. shoqëria administruese ose çdo aksionar i shoqërisë administruese;
 - b. depozitari i Fondit;
 - c. sponsori në një fond me pjesëmarrje të mbyllur nëse nuk përmbush kërkesat e parimit të diversifikimit të portofolit
 - d. çdo person, palë e lidhur me entitetet e radhitura në pikat (a) (b)dhe (c) të këtij paragrafi;

2.5 HUAMARRJA

Shoqëria administruese mund të marrë hua vetëm për llogari të fondit të pensionit deri në 5% të vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit vetëm për qëllime likuiditeti dhe në baza të përkohshme.

Shoqëria administruese për llogari të fondit të pensionit mund të marrë hua nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes (REPO) për një periudhë që nuk i kalon 90 (nëntëdhjetë) ditë. Shoqëria administruese raporton në Autoritet mbi huamarrjet për llogari të fondit të pensionit.

Transaksionet e marrëveshjeve të Riblerjes kryhen vetëm pasi është nënshkruar një marrëveshje kuadër mes shoqërisë administruese dhe palës tjetër.

2.6 Aprovimi dhe ndryshimi i politikës së investimit

Politika e investimit e Fondit të Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur Raiffeisen është pjesë e prospektit të fondit, dhe prospekti miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Politika e investimit është objekt rishikimi nga Komiteti i Investimeve dhe çdo ndryshim i rëndësishëm i saj, që ka të bëjë me ndryshim të objektivave të investimit, të strategjisë së investimit apo profilit të rrezikut të fondit do të miratohet nga Këshilli i Administrimit përpara se të përfshihen në Prospektin e Fondit. Këto ndryshime janë objekt i miratimit edhe nga Autoriteti.

Çdo ndryshim i rëndësishëm i politikës së investimit do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese, menjëherë pas miratimit të prospektit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese njofton me postë normale ose elektronike të gjithë anëtarët në fond për ndryshimet e rëndësishme të politikës së investimit dhe të prospektit brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së miratimit nga Autoriteti.

Çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit pa paguar komision transferimi brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit.

2.7 Politika e ekzekutimit më të mirë

Në përputhje me "Politikën e ekzekutimit më të mirë" të zbatuar nga shoqëria administruese, ekzekutimi optimal i vendimeve të tregtimit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

2.7.1 Faktorët e ekzekutimit

Për sa i përket transaksioneve specifike, faktorët e mëposhtme të ekzekutimit janë të rëndësishëm për të arritur në mënyrë të vazhdueshme rezultatet më të mira të mundshme të ekzekutimit për fondin ose portofolin në terma afatgjatë: norma e interesit / çmimi, tarifat / kostot, natyra / madhësia e transaksionit, shpejtësia e ekzekutimit, probabiliteti i ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes.

Duke marrë parasysh faktorët më të mirë të ekzekutimit dhe për të përcaktuar rëndësinë e tyre relative, konsiderohen elementët e mëposhtëm: karakteristikat e fondit siç janë objektivi i investimit, politika e investimit dhe profili i rrezikut të fondit; karakteristikat e urdhërit të dhënë; karakteristikat e instrumenteve financiare që janë subjekt i këtij urdhëri; karakteristikat e vëndeve të ekzekutimit të cilave mund t'u drejtohet ai urdhër; gjendja e likuiditetit në kohën e ekzekutimit. Shoqëria administruese pas përfundimit të çdo transaksioni kontrollon nëse transaksioni i kryer është konform me të dhënat e tregut.

2.7.2 Përzgjedhja e ndermjetësve/ palëve

Raiffeisen Invest sh.a siguron të ketë marrëdhënie të mira me partnerë me reputacion të lartë, me qëllim që të maksimizojë cilësinë e ekzekutimit në raport me vlerën e kostos së ekzekutimit.

Përzgjedhja e partnerëve tregtarë (ndërmjetësve), të cilëve mund t'u përcillen urdhërat, bëhet në bazë të kriterëve të paracaktuara. Në veçanti, konsiderohen kriteret e mëposhtme: shpejtësia e ekzekutimit, vëllimi i tregtuar, aftësia për tu kryer pa probleme dhe në kohën e duhur, sigurimi i ekzekutimit optimal të urdhërave, informacioni për tregun (informacioni teknik), reputacioni i ndërmjetësit.

Pas fillimit të marrëdhënieve të biznesit, partnerët e tregtimit i nënshtrohen vlerësimeve të rregullta nga shoqëria administruese.

2.7.3 Vendet e ekzekutimit

Vëndet e ekzekutimit që mundësojnë ekzekutimin më të mirë për secilin Instrument Financiar në mënyrë të qëndrueshme, janë tregjet e rregulluara vendase dhe ndërkombëtare të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

Tregjet e rregulluara i nënshtrohen rregullave të rrepta të funksionimit, të rregulluara nga organi rregullator përkatës në secilin juridiksion në të cilin ata veprojnë.

Tregu i titujve, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Për këto tituj, transaksionet bëhen me palë të pranueshme në tregun sekondar dhe përmes pjesëmarrjes direkt në tregun primar.

Norma e interesit / çmimi është kriteri kryesor për transaksionet e kryera përmes platformave të tregtimit. Normalisht faktorët e ekzekutimit renditen si më poshtë:

1. Norma e interesit / çmimi
2. Shpejtësia e ekzekutimit
3. Mundësia e ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes
4. Natyra / madhësia e transaksionit
5. Tarifat / kostot

Një diferencim themelor mund të bëhet për sa i përket strukturimit të likuiditetit të këtyre instrumenteve individuale. Nëse likuiditeti është relativisht i lartë, kriteret tilla si norma e interesit / çmimi dhe shpejtësia e ekzekutimit marrin një vlerë më të lartë. Nëse likuiditeti është më i ulët, më shumë peshë i jepet llojit të urdhërit, si dhe mundësisë së ekzekutimit dhe përmbylljes së tij.

Për instrumentet e tregut të parasë siç janë depozitat, transaksione të Marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të Riblerjes (repo / reverse repo), renditja e mëposhtme e faktorëve të ekzekutimit konsiderohet kur vendoset për një palë:

1. Norma e interesit
2. Vlerësimi i kreditit të Palës
3. Mundësia e ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes
4. Natyra / madhësia e transaksionit
5. Tarifat / kostot

03

Rreziqet që lidhen me investimet dhe strukturën e aktiveve të fondit

Investimi në Fond detyrimisht përfshin marrjen e rrezikut nga investitori. Rreziqet kryesore ndaj të cilave Fondi është i ekspozuar janë Rreziku i tregut, Rreziku i Kredisë, Rreziku Operacional, Rreziku i Likuiditetit, Rreziku i Agjencisë, Rreziku Ligjor, Rreziku Reputacional.

Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një njësi të vecantë, përgjegjëse për evidentimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve që shoqërojnë investimet e kryera në emër të Fondit, veprimtaria e të cilës udhëhiqet nga Politika e Administrimit të Rrezikut Rreziku.

Më poshtë është një analizë tabelore e rreziqeve kryesore, ndikimi i tyre dhe metodat e administrimit:

Rreziku	Përshkrimi	Shkalla e Ndikimit	Metodat e Administrimit
Rreziku i tregut	Rreziku i tregut është rreziku që tregu i instrumentevefinanciare si i tërë të pësojë ulje, duke shkaktuar një ulje të vlerës së instrumenteve individuale në portofolin e fondit. Performanca e investimeve është veçanërisht e lidhur me zhvillimet në tregjet e kapitalit, të cilat mund të preken nga situata dhe zhvillime ekonomike apo politike në vend, por edhe nga situata globale e ekonomisë botërore. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e normave të interesit, rrezikun e kursit të këmbimit, rrezikun e inflacionit etj.	E moderuar	Monitorimi i vazhdueshëm i tregjeve dhe analizimi i ndikimit të ndryshimeve makroekonomike në kthimet reale të investimeve.

Rreziku i normës së interesit	Ky rrezik i referohet mundësisë së ndryshimeve në treg të normave të interesit të aplikuara në momentin e emetimit të një obligacioni me kupon fiks ose të një instrumenti të tregut të parasë. Ndryshimet në tregun e normave të interesit mund të shkaktohen nga faktorë si: ndryshimet e parametrave ekonomikë dhe rezultateve financiare të emetuesit. Nëse normat e interesit rriten, atëherë çmimet e titujve të borxhit bien. Nga ana tjetër, nëse normat bien, atëherë do të kishim një efekt të kundërt në çmimin e titujve të borxhit. Sidoqoftë, luhatshmëria e çmimeve varion në funksion të kohëzgjatjes së titullit. Titujt më afatshkurtër janë më pak të rrezikuar nga luhatshmëria e normave sesa ata afatgjatë.	E ulët	Shumica e obligacioneve vlerësohen si aktive të mbajtura deri në maturim (HTM). Ky model synon minimizimin e ndikimeve nga luhatjet e normave të interesit dhe ofron stabilitet në përmbushjen e detyrimeve afatgjata të fondit. Menaxhimi i Kohëgjatjes (Duration) të portofolit, përdoret për obligacionet që vlerësohen si të vlefshëm për shitje (AFS) dhe që ndikohen nga ndryshimi i normave të interesit.
Rreziku i kursit të këmbimit	Është mundësia që zhvlerësimi i monedhës të ndikojë negativisht vlerën e një titulli ose investimit në tërësi. Kjo vlen veçanërisht për ato tituj të emetuar në monedha të ndryshme nga leku.	Nuk ka ndikim	Duke qenë se investimet e fondit janë të gjitha në monedhën vendase Lekë ky rrezik nuk ka ndikim material.
Rreziku i kredisë	Rreziku i kredisë lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aktiveve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, çka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e aktiveve të Fondit. Fondi i Pensionit përbëhet kryesisht nga investime në tituj borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, rrjedhimisht rreziku i kredisë për këtë fond vlerësohet i njëjtë me atë të shtetit shqiptar.	E ulët	Analiza e qëndrueshmërisë financiare të Qeverisë së RSH dhe monitorimi i vlerësimeve të kreditit.
Rreziku Operacional	Është rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.	E ulët – E moderuar	Metodat përfshijnë: • Vlerësimin e Risqeve • Treguesit e paralajmërimit të hershëm • Analizat bazuar në skenarë • Mbledhja e të dhënave lidhur me ngjarjet e rrezikut operacional
Rreziku i Likuiditetit	Është rreziku që një pozicion nuk mund të likuidohet në kohë të përshtatshme me një çmim të përshtatshëm.	E moderuar	Analiza e nevojave për likuiditet dhe mbajtja e një niveli të përshtatshëm likuiditeti.
Rreziku Ligjor	Është rreziku i humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paafhtësia e shoqërisë administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licensat dhe/ose të drejtat e pronësisë.	E ulët	Shoqëria ka në strukturën e saj një njësi të dedikuar për çështjet ligjore dhe përputhshmërinë, e cila siguron zbatimin rigoroz të kuadrit ligjor.
Rreziku i Agjencisë	Është rreziku dëmi që mund t'i shkaktohet fondit nga vendimmarrje të qëllimshme të administratorëve të shoqërisë apo manaxherët e fondit, për interesa personale dhe në kundërshtim me interesat e investitorëve të fondit.	E ulët	Qeverisja e brendshme bazuar në struktura efektive si: Asambleja e Aksionerëve, Këshilli Administrimit, Administratorët Ekzekutivë dhe Komiteti i Investimeve Struktura organizimit që siguron mirëndarje të detyrave Transparenca me Investiorët përmes raportimeve periodike Politikat për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit dhe Politikat e Ekzekutimit më të mirë

Rreziku Reputacional	Rreziku reputacional nënkupton rrezikun e dëmtimit të besueshmërisë së Shoqërisë Administruese në tregun ku vepron. Ky rrezik përmbledh impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht mbi perceptimin e publikut për shoqërinë	E moderuar	Sigurimi i transparencës me investitorët dhe publikun mbi performancën e fondeve dhe çështje të tjera që lidhen me to. Vendosija e një mekanizimi efektiv për menaxhimin e ankesave dhe adresimin e tyre
Rreziku i Përputhshmërisë	Është referohet rrezikut të ekspozimit ndaj penalteteve, sanksioneve ligjore, humbjeve reputacionale ose kufizimeve operationale si pasojë e mosrespektimit të ligjeve, rregulloreve, dhe politikave, procedurave të brendshme.	E ulët	Shoqëria administruese ka një njësi të dedikuar për përputhshmërinë, e cila siguron respektimin e kuadrit rregullator përmes kontrolleve të vazhdueshme dhe raportimeve periodike.
Rreziku i Ndryshimit të Tatimit	Ky risk lidhet me ndryshime të mundshme në legjislacionin tatimor me efekt mbi fondet e pensionit privat. Këto ndryshime mund të konsistojnë qoftë në vendosjen e një regjimi tatimor të ndryshëm apo edhe një rritje të mundshme të normës së tatimit mbi të ardhurat personale, të cilat mund të kenë impakt në vlerën e pagesave të pensionit për anëtarin që tërhiqet nga Fondi, si në mënyrë të parakohshme ashtu edhe kur ka mbushur moshën e pensionit	E mesme	Monitorimi i legjislacionit tatimor dhe përshtatja me ndryshimet për të minimizuar ndikimin.
Rreziku i Depozitarit	Rreziku që depozitari i fondit të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ligjore si ruajtja e aseteve të fondit dhe detyrime të tjera.	E ulët	Funksioni i depozitarit mbulohet nga një shoqëri e licencuar nga AMF.

Profili i Rrezikut dhe Toleranca:

Fondi ka një profil të ulët të rreziku, i ndikuar nga natyra konservative e investimeve të tij. Investimet përqendrohen ekskluzivisht në tituj borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të cilët vlerësohen si aktive të mbajtura deri në maturim (HTM) dhe janë të denominuar në lek. Kjo qasje siguron stabilitet dhe besueshmëri në kthimet afatgjata, duke minimizuar ekspozimin ndaj luhatjeve të tregut financiar. Si i tillë, fondi është i përshtatshëm investitorë me një tolerancë të ulët ndaj rrezikut, të orientuar drejt ruajtjes së kapitalit dhe kthimeve afatgjata të qëndrueshme.

Të dhëna historike

4.1 Të dhëna mbi fondin në datë 31 dhjetor 2024

Në datë 31.12.2024 vlera neto e aktiveve të Fondit është 1,663,225,079 Lekë. Kthimi vjetor neto i fondit është 4.60% për periudhën 31 Dhjetor 2023 – 31 Dhjetor 2024. Komisioni vjetor i e administrimit për vitin e mbyllur më 31.12.2024 është 1.50%.

Në datë 31 Dhjetor 2024, kthimi nga investimi i fondit është 4.40% me bazë vjetore për pesë vitet e fundit dhe 5.94% me bazë vjetore që nga fillimi i funksionimit të fondit.


Në 31 Dhjetor 2024 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Instrumenti	Në Përqindje të aktiveve
Obligacione Thesari të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	99.6
Cash në Llogari rrjedhëse	0.4

4.2 Të dhëna mbi performancën e fondit

Në grafikun më poshtë është paraqitur performanca vjetore e shkuar e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen.

Kthimi vjetor i përket datës 31 Dhjetor të çdo viti dhe paraqet përfitueshmërinë neto të fondit, pasi është zbriturkomisioni vjetor i administrimit.



Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen.

05

Skenarë të ndryshëm për pensionin

Më poshtë ilustrohen me Shembuj skenarë të ndryshëm se si ndikon kohëzgjatja e periudhës së investimit në Fond (e lidhur kjo me moshën e Anëtarit) dhe masa e kontributit që duhet të derdhë Anëtari në Fond, për të përfituar një pension të përshtatshëm.

Çdo llogaritje është ilustrative, duke marrë për bazë vlera të përafërta, në mënyrë që Anëtari në Fond të kuptojë mënyrën e funksionimit të kësaj skeme pensioni.

Skenarët më poshtë paraqesin informacionin e verifikuar nga një aktuar i autorizuar.

Shembull 1 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	3,000.00	Fondi në dispozicion për pension	6,004,344.56
Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%
Numri i viteve të investimit	40	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	43,016.99
Totali i kontributeve të derdhura	1,440,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	4,319,732.87
Kontribute + interesa të akumuluar	6,004,344.56	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	4,564,344.56
Fondi në dispozicion për pension	6,004,344.56	Totali i interesave të përfituar	8,884,077.43
		Totali interesa+ kontribute	10,324,077.43

Shembull 2 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	3,000.00	Fondi në dispozicion për pension	3,557,703.63
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	40	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	21,558.98
Totali i kontributeve të derdhura	1,440,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	1,616,452.57
Kontribute + interesa të akumuluar	3,557,703.63	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	2,117,703.63
Fondi në dispozicion për pension	3,557,703.63	Totali i interesave të përfituar	3,734,156.20
		Totali interesa+ kontribute	5,174,156.20

Shembull 3 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	10,000.00	Fondi në dispozicion për pension	4,974,531.44
Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	100,000.00	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	35,639.09
Totali i kontributeve të derdhura	2,500,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	3,578,849.74
Kontribute + interesa të akumuluar	4,974,531.44	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	2,474,531.44
Fondi në dispozicion për pension	4,974,531.44	Totali i interesave të përfituar	6,053,381.18
		Totali interesa+ kontribute	8,553,381.18

Shembull 4 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	10,000.00	Fondi në dispozicion për pension	3,902,230.29
Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	100,000.00	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	23,646.75
Totali i kontributeve të derdhura	2,500,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	1,772,989.22
Kontribute + interesa të akumuluar	3,902,230.29	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	1,402,230.29
Fondi në dispozicion për pension	3,902,230.29	Totali i interesave të përfituar	3,175,219.51
		Totali interesa+ kontribute	5,675,219.51

Shembull 5 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	15,000.00	Fondi në dispozicion për pension	7,296,286.94
Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4.00%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	100,000.00	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	44,214.06
Totali i kontributeve të derdhura	3,700,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	3,315,088.33
Kontribute + interesa të akumuluar	7,296,286.94	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	3,596,286.94
Fondi në dispozicion për pension	7,296,286.94	Totali i interesave të përfituar	6,911,375.27
		Totali interesa+ kontribute	10,611,375.27

Shembull 6 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	15,000.00	Fondi në dispozicion për pension	2,652,420.83
Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%
Numri i viteve të investimit	10	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	100,000.00	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	19,002.77
Totali i kontributeve të derdhura	1,900,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	1,908,243.16
Kontribute + interesa të akumuluar	2,652,420.83	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	752,420.83
Fondi në dispozicion për pension	2,652,420.83	Totali i interesave të përfituar	2,660,663.99
		Totali interesa+ kontribute	4,560,663.99

Shembull 7 (në lekë)			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit	
Kontributet mujore	120,000.00	Fondi në dispozicion për pension	4,999,840.75
Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6.00%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e pensionit në vite	20
Shumë e menjëhershme	100,000.00	Numri i kësteve në vit	12
Data e fillimit të pensionit	-	Shuma e pensionit mujor	35,820.41
Totali i kontributeve të derdhura	2,500,000.00	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së pensionit	3,597,058.13
Kontribute + interesa të akumuluar	4,999,840.75	Interesi i përfituar gjatë fazës së investimit	2,499,840.75
Fondi në dispozicion për pension	4,999,840.75	Totali i interesave të përfituar	6,096,898.88
Totali interesa+ kontribute	1.00	Totali interesa+ kontribute	8,596,898.88

Të dhëna për shoqërinë administruese

6.1 Forma ligjore

Raiffeisen Invest sh.a. – Shoqëria administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK, është një shoqëri aksionare, themeluar dhe regjistruar si person juridik më datë 18/07/2005, mbajtëse e numrit të identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) K51928001I me seli në Rr.Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a., e cila zotëron 100% të aksioneve. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 90.000.000 (nëntëdhjetëmilionë) lekë, i cili është shlyer tërësisht.

Raiffeisen Invest sh.a mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"i ndryshuar, Ligjit nr. 76/2023"Për fondet e pensionit privat" dhe Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Raiffeisen Invest ka si objekt të aktivitetit të saj:

- Veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr.1, datë 13.12.2011, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj vepron me ndershmëri dhe paanësi, me aftësinë dhe kujdesin e duhur, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi, rregullat profesionale dhe praktikatat më të mira.

Shoqëria administruese është entiteti juridik qeverisës i të gjithë fondeve nën administrimin e saj, si dhe përfaqësuesi i tyre në lidhje me palët e treta.

6.2 Fondet nën administrim

Raiffeisen INVEST sh.a. administron fondet e mëposhtme:

1. Fondin e investimit Raiffeisen Prestigj (Kodi FI-B1, datë 13.12.2011)
2. Fondin e investimit Raiffeisen Invest Euro (Kodi FI-B2, datë 26.09.2012)
3. Fondin e investimit Raiffeisen Vizion (Kodi FI-B4, datë 30.07.2018)
4. Fondin e investimit Raiffeisen Miks (Kodi FI-B6, datë 23.10.2020)
5. Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur Raiffeisen (Nr.Ref. FP 1, datë 18.10.2010)
6. Fondin Furnizues të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid (Licencë nr.14, datë 28.03.2024)

6.3 Organet drejtuese të shoqërisë administruese

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit, dhe Administratorët Ekzekutivë.

6.3.1 Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarit të vetëm të shoqërisë Raiffeisen Bank, sh.a.

6.3.2 Këshilli i administrimit

Këshilli i administrimit është organi qendror i shoqërisë administruese, i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ai kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat tregtare dhe financiare, të investimit, prospektet e fondeve, etj. Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë si më poshtë:

Znj. Donalda Gjorga: Kryetare e Këshillit të Administrimit

Znj. Donalda Gjorga është aktualisht Drejtore e Departamentit të Thesarit në Raiffeisen Bank. Znj. Gjorga ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (MBA) në fushën e Administrimit të Biznesit pranë Fakultetit Ekonomik Tiranë. Donalda ka një eksperiencë të gjatë në sistemin bankar që nga viti 2002 dhe në fushën e investimeve në tregjet financiare pranë Departamentit të Thesarit në Raiffeisen Bank që nga viti 2004. Znj. Gjorga ka përfunduar me rezultate maksimale testet finale të mbrojtjes së certifikatave: ACI Dealing dhe ACI Diploma të ofruar nga Financial Market Association, që është shoqata më e madhe ndërkombëtare e traders në tregjet financiare.

Z. Peter Zilinek: Nënkyetar i Këshillit të Administrimit

Z. Peter Zilinek ka një eksperiencë të gjerë në industrinë e menaxhimit të aseteve. Aktualisht ai mban pozicionin e Drejtuesit të Grupit në Departamentin e EQL në Raiffeisen Capital Management, Vienë, Austri. Si pjesë e Qendrës së Kompetencës për Menaxhimin e Aseteve në Raiffeisen Bank International (RBI), ai përfaqëson RBI në këshillat mbikëqyrëse të shoqërive që menaxhojnë fondet e investimeve dhe pensione në shumë vende të Europës Qëndrore dhe Lindore.

Z. Zilinek ka diplomë masteri respektivisht në menaxhim financiar dhe juridik si dhe është mbajtës i titullit CFA.

Znj. Elona Llaci: Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Elona Llaci është aktualisht Drejtore e Departamentit të Strategjisë dhe Inovacionit pranë Raiffeisen Bank, Shqipëri. Ajo ka një eksperiencë të gjerë nga viti 2005 në sektorin Bankar duke mbuluar role të ndryshme si, Financime Projektsh, Vlerësim të Rrezikut të Kredive Korporate, Anëtare e Komitetit të Kredisë në Bankën Raiffeisen. Znj. Llaci ka njohuri të gjera në industri, ekspertizë për t'u orientuar përkundrejt sfidave të ndryshme që vijnë nga një mjedis dinamik biznesi, sikurse ka eksperiencën e nevojshme për të menaxhuar me sukses objektivat e organizatës, duke përqasur zgjidhje inovative me qëllim arritjen e rezultateve të larta. Znj. Llaci është diplomuar në 2004 në degën Financë / Kontabilitet pranë Universitetit të Tiranës, sikurse është një Menaxhere Inovacioni e certifikuar nga Global Innovation Management Institute.

Znj. Gentjana Ciceri: Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Gentjana Ciceri ka një eksperiencë shumë vjeçare në sektorin financiar dhe bankar. Ajo ka mbajtur një gamë të larmishme funksionesh në sektorë të ndryshëm si Retail, Operacione etj. Prej 15 vitesh ka punuar në sektorin Retail të Raiffeisen Bank në pozicionet e Drejtueses së Zhvillimit të Rrjetit, Kartave dhe Bankingut Digjital, Eksperiencës dhe Zhvillimit të klientit. Aktualisht, që nga Prill 2022, mban pozicionin e Drejtorit të Shitjeve Retail dhe Rrjetit të degëve. Për disa vite ka kontribuar si lektore në lëndët Paraja, Bankat dhe Tregjet Financiare, dhe Financa Ndërkombëtare në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe në Universitetin e New York Tiranë.

Znj. Juella Ahmeti : Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Juella Ahmeti është diplomuar për Financë/Bankë në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2000. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në sistemin bankar, në fushën e financës dhe kontabilitetit, raportimit financiar dhe rregullator. Znj. Ahmeti ka një karrierë të gjatë që nga viti 2005 në Raiffeisen Bank, ku ka drejtuar departamentet e Kontrollit Financiar & Buxhetimit, Inteligjencës së Biznesit dhe Analizës Financiare. Që nga muaji Gusht 2020, Znj. Juella Ahmeti është Drejtuese e Divizionit të Financës në Raiffeisen Bank, Shqipëri. Nga 1 Korrik 2024 është anëtare e Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Invest sh.a.

Znj. Edlira Konini: Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Edlira Konini ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (grada Master) në Paris, Francë, në degën e Administrim Biznesit. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në fushën e investimeve dhe tregjeve financiare, që nga viti 2005. Edlira iu bashkua Raiffeisen Invest në vitin 2009, pas një përvoje disa vjeçare si trader në sektorin e Forex-it pranë departamentit të Thesarit dhe Bankingut të Investimeve të Raiffeisen Bank, Shqipëri duke mbajtur fillimisht pozicionin e drejtores së menaxhimit të portofolit e më pas atë të zv. Administratorit të Përgjithshëm. Ka marrë me rezultate të shkëlqyera certifikatën ACI Dealing, të ofruar nga Financial Market Association.

Znj. Alketa Emini: Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Alketa Emini ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (grada Master) në degën e Administrim Biznesit. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në sistemin bankar në Shqipëri, që nga viti 2004. Alketa iu bashkua Raiffeisen INVEST në vitin 2017, pas një përvoje trembëdhjetë vjeçare pranë departamentit të Menaxhimit të Rrezikut të Kredive të Raiffeisen Bank Shqipëri, ku ka mbajtur pozicionin e drejtores së menaxhimit të Rrezikut të Kredive Korporate dhe Biznes i Mesëm. Për një periudhë pesë vjeçare ka qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Raiffeisen Leasing në Shqipëri.

6.3.3 Komiteti i investimeve

Vendimarrja në procesin e rëndësishëm të investimit si dhe mbikëqyrja e këtij procesi i është besuar Komitetit të Investimeve. Komiteti i Investimeve është një organ kolegjal, vendimarrës dhe mbikëqyrës. Ai monitoron nëse procesi i investimit është në përputhje me politikën e investimit të secilit fond të miratuar nga Këshilli Administrimit, si dhe në përputhje me politikën e administrimit të rrezikut dhe kërkesat rregullatore.

6.3.4 Administratorët ekzekutivë

Veprimtaria e përditshme e Shoqërisë administrohet nga 2 (dy) Administratorë Ekzekutivë, të cilët janë edhe anëtarë të Këshillit të Administrimit. Ata organizojnë dhe administrojnë veprimtarinë e shoqërisë administruese, përgatisin dhe propozojnë për miratim në Këshillin e Administrimit politikat e biznesit, rregulloret dhe procedurat e brendshme, raportet e zhvillimit të biznesit, si dhe raportet financiare, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e punonjësve që rrjedhin nga kontratat e punës etj.

Administratorët ekzekutivë janë :

1. **Znj. Edlira KONINI – Administratore e Përgjithshme**
2. **Znj. Alketa EMINI- zv. Administratore e Përgjithshme**

6.3.5 Personeli kyç i shoqërisë

Personeli kyç i Shoqërisë Administruese përbëhet si vijon:

Z. Lizandër Saraci - Drejtor i Departamentit të Administrimit të Rrezikut.

Përgjegjës për identifikimin, analizimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me aktivitetet e investimit, sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat rregullatore dhe mbrojtjen e aseteve të kompanisë. Menaxheri i Rrezikut do të luajë një rol vendimtar në mbajtjen e një kuadri të shëndoshë të menaxhimit të rrezikut, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve të mundshme dhe ofrimin e udhëzimeve strategjike për organizatën.

Znj. Rezarta Arapi - Drejtore e Departamentit të Administrimit të Investimeve.


Përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin efektiv të politikës së investimit të fondit, me qëllimin kryesor përmbushjen e objektivave financiare në lidhje me ecurinë dhe performancën e tij. Ajo vlerëson vazhdimisht mundësitë më të mira për investim, analizon ecurinë e tregjeve financiare, mbikëqyr ecurinë e portofolit të investimeve dhe ekzekuton investimet brenda kufijve të politikës së investimit, duke u siguruar që procesi i investimit të jetë në përputhje me Prospektin e fondit, me legjislacionin shqiptar dhe kuadrin rregullator, si edhe me rregulloret e shoqërisë administruese dhe direktivat e Grupit Raiffeisen.

Znj. Brunilda Haxhimihali (Emini) - Drejtore e Departamentit Ligjor, Përputhshmërisë & Parandalimit të Pastrimit të Parave (PPP).

Përgjegjëse për të siguruar përputhshmërinë me kuadrin ligjor e rregullativ të aktivitetit tregtar të shoqërisë përfshirë edhe fondet nën administrim. Ajo përfaqëson interesat ligjore të shoqërisë tek autoritetet mbikëqyrëse dhe palët e treta; zhvillon dhe monitoron zbatimin e kërkesave lidhur me qeverisjen e korporatës si dhe drejton parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, krimit financiar dhe detyra të tjera të lidhura me përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit lokal dhe Grupit Raiffeisen.

Personeli kyç nuk ushtron asnjë funksion drejtues në shoqërinë mëmë apo shoqëri tjetër pjesë e grupit financiar.

6.3.6 Struktura organizative e shoqërisë administruese



6.4 Delegimi i disa funksioneve të shoqërisë administruese tek palët e treta

6.4.1 Delegimi i disa funksioneve tek Raiffeisen Bank sh.a.

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shfrytëzimin e sinergjive brenda grupit Raiffeisen, disa funksione të shoqërisë administruese i janë deleguar Raiffeisen Bank sh.a. Mbështetur në eksperiencën dhe standardin e ushtrimit të veprimtarisë nga Raiffeisen Bank sh.a., vlerësohet se delegimi është në interesin më të mirë të anëtarëve në Fond.

Raiffeisen Bank sh.a., në bazë të marrëveshjeve të shërbimit të lidhura me shoqërinë administruese ka marrë përsipër kryerjen e plotë ose të pjesshme të funksioneve të mëposhtme:

- Burimet njerëzore: mbështet shoqërinë administruese lidhur me politikat e trajnimeve të punonjësve në përputhje me standardet e Grupit, si dhe politikat e brendshme të saj (Manuali i Personelit, Kodi i sjelljes etj);
- Marketingu dhe Marrëdhëniet me Publikun: zhvillon dhe implementon strategjinë e marketingut të shoqërisë administruese, siguron mbështetjen e duhur në fushatat e komunikimit dhe promovimit të imazhit në përputhje me standardet e Grupit, si dhe mban marrëdhëniet me palët e treta që ofrojnë shërbime të Marketing-ut dhe Marrëdhënieve me Publikun;
- Shitja dhe Shpërndarja: kryen procesin e shitjes së kuotave të fondit në rolin e agjentit të shitjes të Fondit;
- Administrimi i Rrezikut operacional: këshillon dhe udhëzon lidhur me politikat e administrimit të rrezikut operacional sipas standardeve të Grupit, vlerësimit të risqeve dhe përcaktimit të indikatorëve paralajmërues të rrezikut, trajnime për punonjësit lidhur me masat parandaluese etj;
- Auditi i brendshëm: kryen funksionin e plotë të auditimit të brendshëm nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të cilat sigurojnë përputhshmërinë e aktivitetit dhe procedurave të brendshme të Shoqërisë Administruese, me kuadrin ligjor dhe standardet e Grupit Raiffeisen, si dhe identifikimin e problematikave dhe ekspozimin ndaj risqeve me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrolleve; Auditi i brendshëm raporton në organet drejtuese të shoqërisë administruese;

- Manaxhimi i arkivës dhe disa funksione administrimi;
- Teknologjia e informacionit: mbështet shoqërinë administruese lidhur me zhvillimet hardware dhe software, ndërmarrjen e masave mbrojtëse përfshirë back up të të dhënave dhe rikuperimin e sistemit, mirëmbajtjen e serverave dhe zhvillimin e arkitekturës së tyre, dizenjimin dhe mirëmbajtjen e procedurave të rikuperimit të sistemeve në rast katastrofash etj;
- Siguria: kryen shërbimet e sigurisë së informacionit, sigurisë fizike si dhe shërbime të vazhdimësisë së biznesit. Ofron trajnime lidhur me këto shërbime;
- Përputhshmëria, Parandalimi i Pastrimit të parave, dhe Parandalimi i mashtrimit: ushtron masat e vigjilencës së duhur për parandalimin e pastrimit të parave, sanksioneve financiare, përcakton standardet për parandalimin dhe manaxhon rastet e mashtrimit dhe krimit financiar;
- Mbrojtja e të dhënave: Përcakton standardet dhe drejton procesin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Shoqëria Administruese mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen dhe mbarrëvajtjen e çdo funksioni të deleguar.

6.4.2 Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve

Shoqëria administruese vendos të delegojë disa funksione të aktivitetit të saj në palë të treta duke vënë në plan të parë interesin më të mirë të investitorëve, kjo edhe në rastin kur palë e tretë është shoqëria mëmë.

Çdo palë e tretë që merr përsipër kryerjen e disa funksioneve të deleguara nga shoqëria administruese, është e detyruar të:

1. ndërmarrë masat e nevojshme për identifikimin e konflikteve të interesit;
2. hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për të shmangur konfliktet e identifikuara të interesit;
3. njoftojë shoqërinë administruese për çdo konflikt interesash që nuk mund të shmanget.

Për çdo funksion të deleguar merret miratimi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

6.4.3 Likuidimi vullnetar dhe i detyrueshëm i shoqërisë administruese

Shoqëria Administruese në rrethana të caktuara mund të jetë subjekt i likuidimit vullnetar dhe të detyrueshëm, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare si dhe Ligjin Nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat"

Likuidimi vullnetar dhe i detyrueshëm i shoqërisë administruese miratohet me vendim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Si likuidator emërohen të paktën 2 persona fizikë, për të shitur dhe shpërndarë aktivet e shoqërisë. Likuiduesit janë persona fizikë, që janë të aftë dhe të përshtatshëm për të kryer detyrat e tyre dhe kanë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit vendimin si në rastin e likuidimit vullnetar ashtu edhe në rastin e vendosjes në likuidim të detyrueshëm.

Në çdo rast, aktivet e fondit të pensionit, që ka nën administrim shoqëria administruese, nuk mund të jenë objekt ekzekutimi si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar, dhe as të shlyerjes apo të ekzekutimit të pretendimeve kundrejt shoqërisë administruese.

6.5 Informacion për audituesin ligjor të shoqërisë administruese

Audituesi ligjor i Shoqërisë Administruese është:

RSM Albania Sh.p.k., me seli në adresën: Rruga Skënder Luarasi, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, Tiranë, Shqipëri,

Përfaqësuar nga: Elona Bisha (Administrator) - E-mail: Elona.bisha@rsm.al

Personi kontaktues sekondar: Fatian Devija (Partner) – E-mail: fatian.devija@rsm.al

Website: <https://www.rsm.global/albania>

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Informacion lidhur me depozitarin

Shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Bankën e Parë të Investimeve, Albania sh.a, themeluar dhe regjistruar si person juridik më datë 19.04.2006, me NIPT K72014801, me seli në adresën: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë, e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr.13, datë 10/03/2010, si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbimin e depozitarit për fondet e pensionit me Licencë nr. 1 datë 13.12.2011.

Depozitari është dhe do të jetë tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo pale tjetër e lidhur me të.

Funksionet e Depozitarit janë si më poshtë:

- a. mban dhe regjistron aktivet e fondit;
- b. monitoron vazhdimisht flukset e mjeteve monetare të fondit dhe në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga anëtari ose në emër të anëtarit dhe se të gjitha mjetet monetare të fondit të pensionit janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të fondit, shoqërisë administruese për llogari të fondit ose të depozitarit për llogari të fondit;
- c. mban regjistrin e anëtarëve të fondit dhe të dhënat për çdo transferim për fondin e pensionit;
- d. mban llogari për aktivet e fondit të pensionit dhe siguron ndarjen e aktiveve për secilin fond për të cilin ofron shërbimet e depozitarit nga aktivet e depozitarit dhe klientëve të tjerë të depozitarit dhe shoqërisë administruese;
- e. kontrollojnë që aktivet e fondit të pensionit investohen në përputhje me objektivat dhe strategjinë e investimit të miratuar, dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- f. informon Autoritetin dhe shoqërinë administruese për procedurën e llogaritjes së vlerës së aktiveve dhe çmimit të kuotës së fondit të pensionit, konfirmon llogaritjen dhe siguron që llogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimi i kuotës së fondit të pensionit janë kryer në përputhje me politikat e miratuara të kontabilitetit, metodologjitë e vlerësimit, si dhe në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- g. ekzekuton urdhrat e shoqërisë administruese në lidhje me transaksionet e aktiveve të fondit, nëse nuk bien ndesh me Ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- h. raporton te shoqëria administruese për veprimet tregtare në lidhje me aktivet e fondit të besuara në kujdestari dhe ekzekuton urdhrat e shoqërisë administruese;
- i. garanton kthimin e çdo shume përkatëse fondit të pensionit brenda afateve kohore të përcaktuara;
- j. siguron që të gjitha të ardhurat, që rrjedhin nga transaksionet me aktivet e fondit, të dërgohen në llogarinë e fondit brenda afateve të përcaktuara;
- k. garanton se të ardhurat e fondit të pensionit përdoren në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- l. sigurohet që kostot ose tarifat e paguara nga fondi i pensionit janë në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- m. kryen të gjitha detyrat e tjera të parashikuara në kontratën për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit të fondit të pensionit.

7.1 Konflikti i interesit

1. Depozitari gjatë kryerjes së detyrave të tij, vepron me kujdesin e një eksperti të mirë, me ndërgjegje dhe ndershmëri, i pavarur nga shoqëria administruese, aksionarët e saj ose anëtarët e fondit për të cilin kryen veprimtari Depozitari.
2. Depozitari nëpërmjet strukturës së tij organizative dhe akteve të brendshme gjatë kryerjes së veprimtarisë dhe detyrave të parashikuara nga Ligji dhe kontrata me Shoqërinë Administruese për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit, duhet të shmangë konfliktin e interesit midis vetë depozitarit, aksionarëve dhe/ose mbajtësit të pjesëmarrjes influencuese dhe shoqërisë administruese.
3. Konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme nga strukturat përgjegjëse, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interes të anëtarëve të fondit.
4. Depozitari nuk zotëron licencë si shoqëri administruese.
5. Personat kyç, personeli kyç dhe punonjës të tjerë të depozitarit nuk mund të jenë persona kyç, personel kyç dhe punonjës të shoqërisë administruese dhe anasjelltas.



Publikuar në Maj 2025